



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 58 regjistër (JR)
Datë 16.12.2020

Nr. 6 i vendimit
Datë 16.02.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.02.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 58/2020 (JR), datë 16.12.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 313, datë 10.11.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rabiana Halili.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, si dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në datën 01.10.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) se, në datën 30.09.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) me vendimin nr. 201, datë 30.09.2020, ka miratuar mbarimin e statusit të saj të magjistrates, për shkak të dorëheqjes nga detyra e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë komunikim drejtuar Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: *Për këtë arsye, në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 65/3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkoj ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.*
3. Në datën 02.10.2020, KLP-ja i ka përcjellë Komisionit¹ vendimin e saj nr. 201, datë 30.09.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, me anë të të cilit ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistrates për znj. Rabiana Halili, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me efekt nga data 02.10.2020.
4. KLP-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.10.2020², drejtuar Komisionit, ka informuar këtë të fundit: *Lidhur me vendimin e KLP-së nr. 201, datë 30.09.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit znj. Rabiana Halili”, ju informojmë se nuk ka ankim ndaj këtij vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.*
5. Komisioni në datën 27.10.2020, nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* në adresën elektronike private të subjektit të rivlerësimit, ka bërë me dije këtë të fundit mbi të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore dhe në vijim e ka ftuar atë të shprehë vullnetin mbi ushtrimin apo jo të kësaj të drejte. Subjekti i rivlerësimit në datën 28.10.2020, në përgjigje të këtij komunikimi elektronik, ka informuar Komisionin se nuk do të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
6. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, me vendimin nr. 313, datë 10.11.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 313, datë 10.11.2021, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, vendosi:
 1. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

¹ Nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 30.09.2020, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 02.10.2020.

² Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.10.2020.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

[...]

III. Shkaqet e ankimit

8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, më datë 01.12.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 313, datë 10.11.2020, duke kundërshtuar vetëm pikën 2 të tij me përmbajtje: *Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.*
9. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo pjesë e dispozitivit të vendimit konsiston në një parashikim joproporcional dhe në kundërshtim me parimet bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), si dhe se ky vendim është marrë në shkelje të rënda të ligjit procedural, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në vlefshmërinë e tij dhe e bëjnë atë të cenueshëm nga organet më të larta të kontrollit, siç është Kolegji.
10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e saj, të vendosë:
 - ° *Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 313, datë 11.10.2020, të Komisionit.*
11. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1 Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, pretendoi se janë kryer shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, duke e detyruar atë të japë dorëheqjen nga detyra. Subjekti pretendoi cenim të parimit të paanësisë dhe pavarësisë, si pasojë e (i) shqyrtimit të çështjes së rivlerësimit nga një trupë gjyqësore, dy prej anëtarëve të së cilës nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj për t’u zgjedhur komisionerë; (ii) mungesës së përfaqësimit në përbërje të Komisionit të personave me eksperiencë profesionale nga sistemi gjyqësor; si dhe (ii) përfshirjes së çështjes në Komision me rekomandim të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), ku shkaqet e këtij rekomandimi nuk janë bërë transparente dhe, në këtë kuptim, është cenuar parimi i paanësisë dhe pavarësisë së trupës gjyqësore të Komisionit, për shkak të paragjyqimit që u krijua për personat e përfshirë në listën e rekomanduar nga ONM-ja.

11.2 Lidhur me pikën 2 të vendimit objekt ankimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, pretendoi se “sanksioni” i vendosur nga Komisioni në këtë pikë të vendimit është i rëndë, ka karakter ndëshkues dhe, pavarësisht se i miratuar në Kushtetutë, është joproporcional, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, me dorëheqjen nga detyra, nuk ka pasur qëllim t’i shmangët procesit të *vetting-ut*, por vetëm të zgjedhë, në përputhje me të drejtat dhe liritë e saj, një tjetër punë që nuk i cenonte asaj të drejtën e një jete të qetë familjare.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Rabiana Halili, dhe për të cilin ajo, nëpërmjet ankimit, kërkon shfuqizimin e pikës 2 të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh³, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 313, datë 10.11.2020, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të

³ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 313, datë 10.11.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Rabiana Halili, i është njoftuar asaj me shkresën nr. {***} prot., datë 10.11.2020, dërguar nëpërmjet një komunikimi elektronik në datën 16.11.2020, ora 11:45, në adresën elektronike {***}, me të cilin i është përcjellë edhe një kopje elektronike e vendimit të Komisionit në formatin pdf. Subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen dijeni të këtij komunikimi me e-mail-in e datës 17.11.2020, ora 08:11. Ndërsa ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit nëpërmjet shërbimit postar TNT më datë 03.12.2020, protokolluar me nr. {***} prot., datë 03.12.2020. Referuar fletëdorëzimit të shërbimit postar TNT, objekti postar është regjistruar më datë 01.12.2020. Në këto kushte, subjekti rezultoi të ketë ushtruar ankim në ditën e 14-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

15. *Lidhur me shkakun e ankimit për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se është cenuar parimi i paanësisë dhe pavarësisë, si pasojë e faktit se dy prej anëtarëve të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e rivlerësimit të saj nuk përmbushin kriteret ligjore për t’u zgjedhur komisionerë. Konkretisht, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, në ankimin e saj i referohen (i) komisionerit L. H. për mospërmbushje të kriterit të përcaktuar në nenin 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, pasi sipas saj në emër të komisionerit L. H. është regjistruar një procedim penal në vitin 2019; dhe (ii) komisioneres Xh. P. pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, kualifikimi i saj është kryer në kundërshtim me ligjin, për sa kohë në listën e përcjellë për herë të parë në Kuvend, znj. P. rezultonte në grupin e kandidatëve të skualifikuar nga Avokati i Popullit. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe GjEDNj-ja ka theksuar në jurisprudencën e saj se jo vetëm gjykata duhet të jetë e parashikuar me ligj, por edhe anëtarët e saj duhet të zgjidhen në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligj. Për më tepër, subjekti ngriti pretendime edhe në drejtim të faktit që asnjë nga anëtarët e trupit gjykues të Komisionit që ka shqyrtuar çështjen e saj, nuk është gjyqtar dhe nuk ka punuar asnjëherë në sistemin gjyqësor. Lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit pretendoi se përbërja e Komisionit nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁴, për të vlerësuar nëse një organ i tillë disiplinor është i pavarur dhe i paanshëm.
16. Në shqyrtim të pretendimeve të parashtruara si më sipër nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, në referim të dispozitave kushtetuese të cilat përcaktojnë gamën e kompetencave të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk përfshihet vlerësimi i plotësisht të kushteve dhe kriterëve të zgjedhjes në detyrë të komisionerëve të Komisionit apo të ndonjë funksionari tjetër, brenda dhe/apo jashtë organeve të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, pretendimi i ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit përpara Kolegjit, për vlerësimin e përmbushjes apo jo të kriterëve ligjore të zgjedhjes në detyrë të anëtarëve të trupit gjykues që kanë shqyrtuar çështjen e rivlerësimit të subjektit ankues në Komision, në funksion të konstatimit të cenimit apo jo të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së trupit gjykues, vlerësohet i pabazuar në ligj. Një qëndrim i tillë konfirmohet edhe nga vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit për pretendime të së njëjtës natyrë⁵. Trupi gjykues çmon të evidentojë faktin se subjekti i rivlerësimit, përveç sa më sipër, nuk ka ngritur asnjë pretendim tjetër në drejtim të rasteve, ekzistenca e të cilave, referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, do të përbënte pengesë ligjore për pjesëmarrjen e këtyre dy komisionerëve në përbërjen e trupit gjykues që do të rivlerësonte subjektin e rivlerësimit, znj. Rabiana Halili. Sikundër nuk është pretenduar nga subjekti asnjë fakt apo rrethanë e cila dëshmon për shprehje njëanshmërie të këtyre dy anëtarëve të trupit gjykues, çka referuar vlerësimit

⁴ Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen *Oleksandr Volkov v. Ukraine*.

⁵ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2020 (JR), parag. 37-38.

sipas qasjes subjektive⁶, trupi gjykues nuk ka arsye të vërë në dyshim cenimin e paanësisë së Komisionit në rastin e vendimmarrjes objekt ankimi.

17. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se mungesa në përbërje të Komisionit e anëtarëve me prejardhje profesionale nga sistemi gjyqësor, cenon paanësinë dhe pavarësinë e trupave gjyqësore të tij, referuar kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁷ për një organ disiplinor, me efekt cenimin e nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues, në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit⁸. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016, i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. [...] Gjykata Kushtetuese, gjatë kontrollit të ushtruar prej saj në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë.*
18. Duke përmbyllur analizën e mësipërme, trupi gjykues konstaton se një pretendim i tillë për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar së fundmi edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj k. Shqipërisë⁹, ka arsyetuar: *[...] Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 109). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces*

⁶ Shih *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, parag. 58; *Micallef kundër Maltës [GC]*, parag. 94.

⁷ Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen Oleksandr Volkov v. Ukraine.

⁸ Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Aneksit të Kushtetutës.

⁹ Kolegji vë në dukje që në datën e shpalljes së këtij vendimi, vendimi i GjEDNj-së për çështjen Xhoxhaj k. Shqipërisë nuk ka marrë ende formë të prerë, referuar parashikimeve të nenit 44, pika 2 e KEDNj-së.

mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe pikërisht kjo është arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart). Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mos pasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.

19. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, ka pretenduar në ankim se ajo është përfshirë në procesin e rivlerësimit kalimtar në Komision me rekomandim të ONM-së, shkaqet e të cilit nuk janë bërë transparente dhe, për rrjedhojë, në vlerësimin e subjektit, Komisioni në shkelje të parimit të paanësisë dhe pavarësisë, ka ndërmarrë ndaj saj hetimin administrativ, për shkak të paragjykitimit që u krijua për personat e përfshirë në listën e rekomanduar nga ONM-ja.
20. Trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, çmon fillimisht të theksojë se, në zbatim të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë do t'i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit *ex officio* dhe se ndërmarrja e hetimit administrativ ndaj tyre përbën kusht thelbësor për kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe Komisioni nuk ka, në drejtim të sa më sipër, asnjë kompetencë për vlerësim diskrecionar. Më konkretisht, sa i takon këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të faktit të pretenduar prej saj, se përfshirja në procesin e rivlerësimit kalimtar është bërë sipas një rekomandimi të ONM-së, dhe se si pasojë e këtij rekomandimi, Komisioni ka paragjykuar subjektet e përfshira në listën e rekomanduar nga ONM-ja, duke nisur ndaj tyre hetimin administrativ në cenim, sipas saj, të parimit të paanësisë dhe pavarësisë. Gjithashtu, në fashikullin e përcjellë nga Komisioni, nuk u evidentua nga trupi gjykues asnjë e dhënë apo informacion lidhur me sa më sipër. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky pretendim mbeti në nivel deklarativ, i pabazuar në fakte.
21. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shkak i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të cenimit të parimit të pavarësisë dhe paanësisë, nuk gjendet i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, nuk përbën shkak për cenueshmërinë e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit objekt ankimi.

22. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, pretendoi se pika 2 e vendimit të Komisionit konsiston në vendosjen e një “sanksioni” të rëndë, me karakter ndëshkues dhe joproporcional, duke qenë se dorëheqja e saj nga detyra nuk ka pasur për qëllim shmangien nga procesi i rivlerësimit, porse ka ardhur si rrjedhojë e rrethanave të shkeljeve procedurale të Komisionit dhe është në përputhje me të drejtat dhe liritë e saj për të zgjedhur një tjetër punë që nuk cenon as të drejtën e një jete të qetë familjare, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për çështje të ngjashme¹⁰. Referuar vendimmarrjeve të mëparshme, Kolegji ka arritur në përfundimin se vlerësimi nëse kufizimi i parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është proporcional apo jo, nuk mund të jetë objekt i gjykimit në Kolegji, për sa kohë që ai është një parashikim kushtetues. Kolegji është shprehur gjithashtu se në arritjen e këtij përfundimi ka mbajtur parasysh edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017 (V-2/17)¹¹.
23. Gjithashtu, edhe sa u takon pretendimeve lidhur me vullnetin e subjekteve të rivlerësimit për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, Kolegji në vendimmarrje të tij të mëparshme¹² ka arsyetuar se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Sipas Kolegjit, në momentin që subjekti i rivlerësimit vendos me vullnetin e tij të lirë të ndërpresë detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, duhet të marrë parasysh edhe pasojat juridike që do të sjellë dorëheqja nga detyra, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
24. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, se si pasojë e shkeljeve të rënda procedurale të Komisionit, ajo është detyruar të japë dorëheqjen nga detyra e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është pretendim i pabazuar në ligj, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, referuar parashikimeve të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, kishte në dispozicion instrumentin e nevojshëm procedural ligjor për të kundërshtuar para Kolegjit, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, vendimmarrjen e Komisionit, sipas saj në shkelje të të drejtave procedurale, duke kërkuar korrigjimin e tyre, pa hequr dorë nga detyra e prokurores dhe pa humbur, për pasojë, statusin e magjistrates. Për rrjedhojë, trupi gjykues e çmon këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit pa ndikim në analizën shkak-pasojë, në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
25. Në vijim të analizës së mësipërme, dorëheqja e subjektit të rivlerësimit nga detyra e prokurores pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës u vlerësua nga trupi gjykues si një akt vullneti i lirë për të ndërprerë detyrën funksionale që e bënte znj. Rabiana Halili subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Kjo dorëheqje është shqyrtuar nga ana e KLP-së dhe vendimi përkatës i këtij institucioni kushtetues nuk rezulton të jetë

¹⁰ Shih arsyetimin e vendimit të Kolegjit nr. 17/2019 (JR), parag. 22.

¹¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e “Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike”, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹² Shih arsyetimin e vendimit të Kolegjit nr. 17/2019 (JR), parag. 21.4 dhe të vendimit nr. 18/2020 (JR), parag. 19.

kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, ishte detyrë e subjektit të rivlerësimit të merrte parasysh që pasojat juridike që do të sillte dorëheqja e saj nga detyra, referuar parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, shtriheshin jo vetëm në drejtim të ecurisë së procesit të rivlerësimit duke e ndërprerë atë, por edhe në vijimësinë e karrierës së saj në sistemin e drejtësisë, duke i vendosur asaj një ndalim të përkohshëm prej 15 vitesh në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Pasoja këto për të cilat edhe vetë subjekti në ankimin e saj pohon se i njeh, por gjithsesi e kundërshton njëherë prej tyre (ndalimin prej 15-vitesh në ushtrimin e funksioneve si më sipër përmendur). Në vijim të sa më sipër, në kushtet kur këto pasoja juridike gëzojnë statusin e parashikimit kushtetues, trupi gjykues çmon se vlerësimi i ashpërsisë dhe i proporcionalitetit të tyre nuk mund të jetë objekt i procesit gjyqësor në Kolegj, pasi ky i fundit nuk ka asnjë diskrecion vlerësimi në këtë drejtim.

26. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 313, datë 10.11.2020, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Rabiana Halili, dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 313, datë 10.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rabiana Halili.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.02.2021, në Tiranë.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi